

There are no translations available.



Fjala e plotë e Presidentit të SPMSH, z. Gëzim Kalaja

Gjatë gjithë kësaj periudhe janë zhvilluar konferenca dhe takime në qendrat minerare të Shqipërisë, sot janë në këtë sallë përfaqësues të industrisë minerare shqiptare.

Jemi mbledhur në Konferencën Kombëtare të Sindikatës së Pavarur të Minatorëve të Shqipërisë siç ka vendosur Kongresi i VI i SPMSH për uljen e moshës së pensionit të pleqërisë. Qëndrimin tonë e përforcon angazhimi që ka marrë politika shqiptare në fushatën elektorale dhe

mesazhi i dërguar nga Kryeministri nëpërmjet ministrit të MSR se realizimi i kësaj kërkesë të SPMSH do të bëhet brenda pranverës së këtij viti. Me këtë rast ftoj në tribunën qendrore z. Shukri Cupi kryetar i Sindikatës së Pavarur të minierës së Bulqizës, z. Dilaver Përkoqha kryetar i Konfederatës së Sindikatave për Bulqizën, z. Jonuz Xhetani Zv /president i SPMSH, z. Vlash Toplana kryetar i Sindikatës së minierave të bakrit BERALB Fushë –Arrëz, z. Shefki Ozuni kryetar i sindikatës së industrisë minerare të pjesës jugore dhe i sindikatës së Katjelit Përrenjas, z. Qamil Hidri përfaqësues i 89 sektorëve të minierave të kromit Batër dhe Krastë. Në tribunë ndodhet dhe z. Sami Kariqi, Zv/ president i SPMSH. Në konferencë është i pranishëm z. Patrick Paskal administrator përfaqësues i minierës së Bitumit Selenicë, dhe z. Bashkim Sala Këshilltar i ministrit MSR të cilët dua t'i përsëris. Ju propozoj 1 minut heshtje për kujtimin e 457 minatorëve të cilët kanë vdekur në nëntokë nga aksidenti. **“I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre”**.



Të nderuar kolegë, të nderuar minatorë, punonjës të nëntokës, të gjitha profesioneve, kolegë të mi që me vite bashkë me mua mbajtët martelin në dorë në galeritë e nëntokës të minierave të Tiranës. Singërisht, sot jam shumë i nderuar, ju e shikoni që nuk kam përgatitur raport, sepse fjalët që do të them jam këtu në mendjen dhe kujtimet e mija në kontaktet me ju. Sot jemi në konferencën kombëtare për të kujtuar shokët tanë të rënë në galeritë e nëntokës shqiptare, për të cilët jo vetëm ne punonjësit e nëntokës, por duhet të kenë nderimin dhe respektin e veçantë politika, ekzekutivi, parlamenti, dhe i gjithë kombi shqiptar. Këtu fillon dhe motivimi i drejtë i kërkesës tonë. Shumë nga shokët tanë të cilët u vranë në galeritë e nëntokës, nuk kanë arritur të dalin nga thellësitë e nëntokës. Në familjet e tyre ka shkuar arkivoli bosh i mbushur me gurë, sa që fëmijët të cilët kanë qenë në një moshë shumë të vogël e njohin babain e tyre vetëm nëpërmjet fotografisë. Vetëm kjo mjafton të dashur kolegë, të nderuar punonjës të nëntokës, që qeveria shqiptare, parlamenti shqiptar, politika shqiptare më tepër se kurrë në çfardolloj konflikti interesash që të jenë, të bashkohen një herë të vetme për të realizur atë që na takon ne minatorëve që kemi derdhur djersën dhe gjakun tonë në galeritë e nëntokës. E fillova kështu fjalën time, sepse ne kemi të gjallë kujtimin e shokëve tanë me të cilët kemi punuar krahë për krahë, me të cilët kemi mbushur vagonat kemi zbritur qymyrin, bakrin, kromin, hekurin, të gjitha mineralet që ka nëntoka shqiptare për t'ia dërguar si "ushqim" industrisë shqiptare të para dhe pas 1990-ës. Qeveria, politika, parlamenti para se të nënshkruajnë kontratat dhe marrëveshjet konçensionare duhet të mendojnë për punëtorët për minatorët. Kjo është detyra e tyre kushtetuese, kjo duhet të jetë dhe detyra e tyre humane.

Me këtë rast i bëj thirrje kryeministrit Edi Rama, kryetarit të Parlamentit të gjithë grupeve parlamentare që në mënyrë urgjente të marrin në studim dhe shqyrtim kërkesën e të gjithë minatorëve të Shqipërisë për uljen e moshës së pensionit. E thashë këtë jo pa qëllim. Ju e shikoni në tribunën qëndrore, sot bashkë me ne ndodhen dhe përfaqësues të sindikatave të tjera, sepse kjo kërkesë e jona nuk është vetëm kërkesë e SPMSH, nuk e meritojnë vetëm anëtarët e BSPSH –së, por është dhe për ato minatorë të cilët bëjnë pjesë në sindikata të tjera dhe të tjerë që nuk bëjnë pjesë në organizatat sindikale. Buka që konsumojmë ne të gjithë nuk ka "ngjyrë politike" ajo është njësoj për të gjithë. Sot këtu nuk jemi mbledhur për të marrë ndonjë vendim, të një proteste apo të një greve.

